



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:345453

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06710169

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.101/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, (në objektin e Gjykatës në veri-Mitrovicë), Kryetari i Trupit Gjykses Avni Mehmeti, me procesmbajtësen Edita Kelmendi-Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit; F.H për shkak të veprës penale Grabitje sipas nenit 317 par.3 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me neni 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej KPRK-së). Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr...../2024 datës 24.12.2024. Shqyrtimi fillestar është mbajtur në prezencën e gjitha palëve, prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë, Sahit Tmava, të pandehurit F.H si dhe mbrojtësit av.Berat Peci dhe pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më datën 09.01.2025, Gjykata e ka shpall publikisht aktgjykimin, ndërsa më datën 14.01.2025 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

F.H nga i ati, e ëma, e vajzërisë, lindur më datë në M....., ku dhe tani jeton në Rrugën “.....” pn, me numër personal:....., i pamartuar, ka të kryer shkollën e filllore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i njëjti;

SHPALLET FAJTOR

- SEPSE:

Më datën 26.11.2024, rreth orës 18.30 min afër pishinës “A.P” në M....., i pandehuri me dashje me qëllim që t’i sjell vetit dobi pasurore të kundërligjshme përmes kanosjes serioze dhe duke përdorur mjetin e fort të rrezikshëm për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, pas marrëveshjes paraprake me të miturën A.K, ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarit A.K. Në atë mënyrë që e mitura A.K përmes rrjetit social “Snapchat” e kishte joshur të dëmtuarin A.K, me të cilin edhe më parë kishte qenë në kontakt dhe kishte shkëmbyer foto dhe mesazhe, pastaj e kishte ftuar në M....., duke i treguar lokacionin dhe kur i dëmtuari kishte arritur në lokacionin e lartcekur me veturën e tij “.....” ngjyrë e zezë me targa, e mitura kishte

hyrë në veturën e tij dhe menjëherë ishte ofruar i pandehuri F.H i cili mbante kapelë në kokë dhe me një mjet të fort - sëpatë në dorë e kishte godit veturën e të dëmtuarit dhe nën kërcënimin për përdorimin e këtij mjete, i dëmtuari nga frika e kishte hapur dritaren e veturës, pastaj i pandehuri e kishte kërcënuar me fjalët; “ka me të mbyt” dhe nën kërcënim arrin t’ia marr paratë në vlerë prej 200 euro si dhe një orë të dorës të markës “Guees” në vlerë prej 800€.

- Me këtë ka kryer veprën penale Grabitja sipas nenit 317 paragrafi. 3 e lidhur me paragrafin. 1 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 72, 79 dhe nenit 317 par.3 e lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 364, 365 dhe 369 të KPP-së, për këtë veprë penale të pandehurit F.H, i;

S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej pesë (5) vjet, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 03.12.2024 e deri sa aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, dhe
- II. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500 € (pesëqind) euro, të cilën dënim-gjobë obligohet ta paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i llogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë.
- III. OBLIGOHET i pandehuri F.H që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, dhe shumën prej 50 euro në emër të taksës për Fondit për kompensimin e viktimave të krimi, të cilat duhet t’i paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- IV. Pala e dëmtuar A.K për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

- Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr...../2024 datën 24.12.2024, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ndaj të pandehurit

F.H, për veprën penale Grabitje sipas nenit 317 par.3 lidhur me paragrafin .1 e lidhur me nenin 31 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej KPRK-së).

- Rrjedha e procedurës penale:

Më datën 09.01.2025 Gjykata për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca është mbajtur në prezencën e palëve, Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Sahit Tmava, të pandehurit F.H si dhe mbrojtësit të tij, av.Berat Peci.

I pandehuri F.H në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, sipas akuzës së prokurorisë.

Prokurori Sahit Tmava dhe mbrojtësi i të pandehurit, F.H, av.Berat Peci, kanë propozuar që të miratohet pranimi i fajësisë i deklaruar nga i pandehuri, pasi kanë vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë, siç përcaktohen me nenin 242 të KPP-ës.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri F.H, dhe në mbështetje të nenit 242 par.6 të KPP-ës, vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë siç janë: raportet policore sipas numrit të rastit, dëshmitë që ka dhënë i dëmtuarit A.K, dëshmia e dëshmitarit K.G, nga raportet mjekësore nga Qendra Emergjente e Spitalit të Përgjithshëm në Mitrovicë, me numër të protokollit datë 26.11.2024 në emër të dëmtuarit A.K, informacionet nga e kaluara kriminale në emër të pandehurit, foto dokumentacioni së bashku me materialet dhe video-incizimet nga vendi i ngjarjes, si dhe vërtetimi i datës 09.01.2025, për pranimin dhe për kthimin e sendeve të dëmtuarit A.K.

Gjykata gjithashtu gjen se i pandehuri e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, pasi i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata ia kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mund ta shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjithashtu është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë në përputhje edhe me rrethanat tjera për matjen e dënimit.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lart, Gjykata konstaton se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri F.H ka kryer veprën penale të Grabitjes sipas nenit 317 paragrafi. 3 e lidhur me paragrafin. 1 e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

-Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjykata ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e *si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar*; dashjen direkte të të pandehurit dhe shkallën e lartë të dashjes së shprehur, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial në këtë veprë penale, mënyrën e kryerjes se veprës penale që siç theksohet më lart i pandehuri ka bashkëpunuar me të miturën dhe e kanë joshur të dëmtuarin të cilin e kanë ftuar në M....., përkatësisht në vendin e ngjarjes ku edhe e ka grabitur, fakti se ka përdorë një mjet të rrezikshme (sëpatën) dhe qëllimin e përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme nën kërcënim, ku të dëmtuarit ia ka marr një shumë të parave në vlerë prej 200€ si dhe një orën në vlerë prej 800€, pastaj, rrezikshmëria e veprës penale, marr parasysht se kemi të bëjmë me një veprë penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore, motivin i veprës -qëllim i përfitimit të dobisë materiale për vete, gjithashtu si rrethanë rënduese është vlerësuar edhe fakti se ndaj të pandehurit janë të regjistruar edhe disa raste tjera penale, në cilësi të dyshuarit dhe të pandehurit për veprat penale të vjedhjes dhe natyrave tjera dhe faktin se më para ka qenë i dënuar për veprë penale me aktgjykim të plotfuqishëm.

Ndërsa, si rrethana lehtësuese, Gjykata e ka marr parasysht dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar për shqiptimin e dënimit më të butë, faktin se i pandehuri është i ri në moshë, ka treguar sjellje korrekte në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, ka kërkuar falje dhe pendim të thellë për veprimet e tij, e ka kompensuar palën e dëmtuar, ashtu që të dëmtuarit ia ka kthyer sendet e grabitura përkatësisht, shumën e parave prej 200 Euro dhe orën e dorën e markës "Guees". Gjithashtu është vlerësuar edhe pranimi i fajësisë nga i pandehuri gjatë shqyrtimit fillestar, pranim ky që ka kontribuar në zbardhjen plotë dhe të shpejtë të çështjes penale. Të gjitha këto rrethana si më lart, janë posaçërisht lehtësues për të pandehurin e të cilat tregojnë që edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj, në përputhje me nenin 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3, Gjykata ka aplikuar zbutjen e dënimit nën minimumin

e paraparë ligjor, sipas nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së. Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit F.H, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat e tjera që i kemi cekur më lart është adekuat dhe jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Sa i përket dënimit me gjobë, përveç rrethanave të cekura, Gjykata ka marr për bazë edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

- Llogaritja e paraburgimit;

Të pandehurit i është llogaritur kohën e kaluar në paraburgim në dënimin e shqiptuar. Për këtë vendim, Gjykata është mbështetur në nenin 79 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë për atë veprë penale, llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

- Kërkesa pasurore juridike;

Lidhur me vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregull civil për realizimin e kërkesës pasurore -juridike, Gjykata ka vendos sipas nenit 462 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se, kanë munguar dëshmitë e nevojshme për të përcaktuar të gjitha llojet e dëmit që ka pësuar në këtë rast i dëmtuari. Andaj në mungesë të dëshmive përkatëse ka qenë e pamundur që gjatë këtij procesin penale të përcaktohet lloji dhe lartësia e dëmit të pësuar nga i dëmtuari.

- Shpenzimet e procedurës penale;

Gjykata ka vendos të obligoj të pandehurin të paguaj shpenzimet e procedurës penale deri në shumën dhe lartësinë e shpenzimeve të shkaktuara. Vendimi për paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës mbështetet në nenin 450 paragrafi 1 dhe 452 paragrafi 1 të KPP, pasi që është konstatuar fajësia e të pandehurit me këtë aktgjykim.

Numri i lëndës: 2024:345453
Datë: 14.01.2025
Numri i dokumentit: 06710169

Nga ajo që u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.101/2024 me datë 14.01.2025

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit me shkrim të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët gjykatën.